



Statistical Office of Kosovo
Enti i Statistikës të Kosovës
Zavod za statistiku Kosova



Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2009

Maj 2011

Vlerësimi programatik i varfërisë në Ballkanin Perëndimor

Banka Botërore
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore
Njësia e menaxhimit ekonomik dhe uljes së varfërisë

Enti i Statistikës i Kosovës
Departamenti i statistikës sociale
Sektori i standardit të jetesës



Statistical Office of Kosovo
Enti i Statistikës të Kosovës
Zavod za statistiku Kosova

Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2009

Vlerësimi programatik i varfërisë në Ballkanin Perëndimor

Banka Botërore
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore
Njësia e menaxhimit ekonomik dhe uljes së varfërisë

Enti i Statistikës i Kosovës
Departamenti i statistikës sociale
Sektori i standardit të jetesës

Maj, 2011

Ky raport është publikim i përbashkët i Bankës Botërore dhe Zyrës së statistikave të Kosovës si pjesë e programit të punës të Bankës Botërore: Vlerësimi Programatik i Varfërisë për Ballkanin Perëndimor (P112410). Ekipi i Bankës Botërore udhëhiqej nga Ken Simler (ECSP3), me ndihmën e Sachiko Miyata dhe Yeva Gyulnazaryan (këshilltarë), nën mbikëqyrjen e Benu Bidani (ECSP3). Ekipi i Entit të Statistikës të Kosovës udhëhiqej nga Bashkim Bellaqa, i ndihmuar nga Emina Deliu dhe Besa Haqifi. Alexandru Cojocar, Agim Demukaj, Borko Handjiski, Ranjit Nayak, Anita Schwarz, dhe Manohar Sharma (grupi i ekspertëve) dhanë komente të dobishme në draftet e hershme të këtij raporti. Ndihma bujare financiare nga Departamenti për Zhvillime Ndërkombëtare nga Mbretëria e Bashkuar u prit me mirënjohje.

Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë dokument nuk i shprehin domosdo pikëpamjet e drejtorëve ekzekutivë të Bankës Botërore ose qeverive që ata përfaqësojnë.

Banka Botërore nuk garanton për saktësinë e të dhënave në këtë punim. Kufijtë, ngjyrat, emërtimet dhe informacionet tjera të paraqitura në hartën në këtë punim nuk nënkuptojnë asnjë gjykim të Bankës Botërore lidhur me statusin ligjor të cilitdo territor, si dhe miratimin ose pranimin e këtyre kufijve.

Përmbajtja

Përmbledhje	iii
1. Hyrje	1
2. Nivelet e varfërisë dhe ndryshimet	2
2.1 Konceptet dhe përkufizimet	2
2.2 Profili gjeografik i varfërisë	4
2.3 Pabarazia	7
2.4 Varfëria relative	8
3. Profili i varfërisë sipas ekonomisë familjare dhe karakteristikave individuale.....	9
3.1 Karakteristikat socio-demografike	9
3.2 Statusi ekonomik dhe i punësimit	11
3.3 Profili i kushtëzuar i varfërisë	15
Probabiliteti i të qenit të varfër	15
Lidhjet e konsumit për ekuivalent të të rriturve.....	16
4. Konkluzionet.....	17
Referencat	18
Aneksat	19

Lista e tabelave

Tabela 1: Varfëria dhe varfëria e skajshme sipas rajonit, 2009	7
Tabela 2: Shpërndarja e të varfërve, 2009	7
Tabela 3: Treguesit e pabarazisë, 2009	8
Tabela 4: Varfëria relative, 2009	8
Tabela 5: Varfëria deh shpërndarja e të varfërve në bazë të burimit kryesor të të ardhurave të ekonomisë familjare 2009.....	12
Tabela 6: Shpeshtësia e varfërisë dhe shpërndarja e të varfërve në bazë të aktivitetit kryesor individual, 2009	13

Lista e figurave

Figura 1: Varfëria dhe varfëria e skajshme për banor, 2009	5
Figura 2: Indeksi i zbrazëtirës së varfërisë për linjën e varfërisë së plotë dhe asaj të skajshme, 2009 ...	5
Figura 3: Sensitiviteti i niveleve të varfërisë rurale-urbane sipas linjës së varfërisë, 2009	6
Figura 4: Prania e varfërisë në bazë të grupmohave (paneli i majtë) dhe shpërndarja e të varfërve dhe popullatës së tërë në bazë të grupmohave (paneli i djathtë) 2009.....	10
Figura 5: Prania e varfërisë në bazë të gjinisë dhe gjinisë së kryefamiljarit, 2009	10
Figura 6: Shpeshtësia e varfërisë dhe shpërndarja në bazë të madhësisë së ekonomisë familjare, 2009	11
Figura 7: Llogaritja e varfërisë në bazë të nivelit më të lartë të arsimimit të kryer, 2009	13
Figura 8: Varfëria dhe shpërndarja e të varfërve në bazë të nivelit më të lartë arsimor të kryer, 2009	15

Përmbledhje

Të dhënat e agraguara makroekonomike sygjerojnë se në krahasim me vendet e tjera në Evropë, Kosova ka pësuar më pak nga kriza financiare. Kosova dhe Shqipëria janë të vetmet shtete në Evropën Jug-Lindore që shënuan rritje në BPV për kokë banori gjatë vitit 2009. Megjithatë, Kosova mbetet një nga vendet më të varfëra në Evropë dhe më e varfëra në Ballkanin Perëndimor. Ky raport azhurnon informacionin mbi varfërinë në Evropë duke u nisur nga Sondazhi mbi Buxhetin Familjar (SBF) të vitit 2009. Sondazhi i vitit 2009 është raundi i parë i plotë i SBF që përdor mostrat e reja master që ishte zhvilluar në vitin 2008. Mostra e re master ofron një pamje më të saktë mbi varfërinë dhe mirëqenien, por megjithëkëtë, ndryshimi në mostër po ashtu nënkupton se rezultatet për SBF 2009 nuk janë drejtpërsëdrejti të krahasueshme me SBF-të e mëparshme. Si rezultat, nuk ka mundësi të përcaktohet shkalla të cilës mund t'i atribuohen ndryshimet e dukshme për të pasur një mostër më përfaqësim më të lartë kundrejt ndryshimeve reale në kushtet e jetesës.

Në vitin 2009 pak më shumë se një e treta e popullsisë (34 për qind) jetonin nën vijën e varfërisë absolute prej 1.55 € për një person të rritur në ekuivalente ditore, dhe 12 për qind jetonin nën vijën e varfërisë së skajshme prej 1.02 €. Zbrazëtira e treguesit të varfërisë ishte 9.6, që tregon se mesatarisht një person në Kosovë realizon vetëm 72 për qind të linjës së varfërisë. Linjat e varfërisë në zonat rurale dhe urbane janë pothuajse të barabarta por dallojnë shumë përgjatë shtatë rejonet e Kosovës. Në raportet më të fundit të Bankës Botërore mbi vlerësimin e varfërisë, niveli i varfërisë absolute në konsum është në masë të konsiderueshme më I ulët sesa është raportuar nga SBF 2005-06. Megjithëse të dy sondazhet nuk mund të krahasohen në mënyrë të besueshme, ka mundësi që së paku disa nga zvogëlimet e varfërisë së dukshme janë reale kur llogaritet rritja modeste në BPV për kokë banori dhe vëzhgimi se pabarazia gjatë kësaj periudhe ka mbetur relativisht e ulët dhe e pandryshuar.

Kosova ka një popullsi të re dhe rinia e Kosovës është joproportionalisht e varfër sa që mbi 40 për qind e të rinjve janë nën moshën 20 vjeçare dhe 60 për qind nga të varfrit janë më të rinj se 30 vjeç (krahasuar me 38 dhe 56 për qind të popullatës së gjithëmbarshme përkatëse nën këto mosha). Ekziston një lidhje e fuqishme në mes të arsimimit dhe varfërisë përderisa për ata që kanë përfunduar shkollimin e mesëm dhe të lartë ka shumë më pak mundësi të jenë të varfër sesa ata që nuk kanë kryer këtë shkollim. Shkalla e varfërisë për kokë banori në vitin 2009 ishte 38 për qind në mesin e atyre që kishin të mbaruar vetëm shkollën fillore krahasuar me 28 për qind të atyre që kishin mbaruar shkollimin e mesëm dhe 11 për qind të atyre me arsim të lartë.

Nuk mjafton vetëm arsimimi. Nevojiten edhe punë më të shumta e më të mira. Pothuajse gjysma e fuqisë punëtore në Kosovë është e papunë, dhe papunësia lidhet fuqishëm me varfërinë. Të papunët në Kosovë janë në masë jo-proporcionale të rinj dhe femra me nivel arsimimi më të mirë sesa popullata e përgjithshme por jo aq e mirë se e atyre që kanë punësim të rregullt. Krijimi i vendeve të mira të punës për të zvogëluar papunësinë – jo vetëm për grupin aktual të qytetarëve të rinj që mund të punojnë, por edhe për popullatën e përgjithshme e cila akoma është në shkollë – është sfida parësore për zvogëlimin e varfërisë në Kosovë.

1. Hyrje

Që nga përfundimi i konfliktit të armatosur në vitin 1999 progresi në përmirësimin e standardeve të jetesës në Republikën e Kosovës, me gjithë performancën solide makroekonomike, ka qenë i ngadalhtë dhe jo i barabartë. Në periudhën menjëherë pas konfliktit rritja ekonomike ishte e shpejtë dhe BPV u rrit në numra tre shifrorë e ndikuar në masë të madhe nga përpjekjet e donatorëve për rindërtim. Pas vitit 2005 rritja ekonomike u ngadalësua në ritme më të ngadalta me një shkallë të rritjes vjetore të BPV rreth 4 për qind nga vitit 2005 deri në 2008 duke u udhëhequr kryesisht nga financimet e donatorëve, remitancat dhe rikthimi në veprimtari ekonomike. Megjithatë, grumbullimi i trendeve pozitive të rritjes kishte vetëm ndikime të kufizuara në zvogëlimin e varfërisë. Vlerësimi më i fundit dhe gjithëpërfshirës i Bankës për varfërinë në Kosovë arriti në përfundimin se gjatë viteve 2003-04 dhe 2005-06 nuk kishte ndonjë ndryshim të mirëfilltë të shkallës së varfërisë (World Bank 2007b).

Kosova përballoi krizën ekonomike në vitet 2008-2009 më mirë se shumica e vendeve në Evropën Jug-Lindore (EJL). Në të vërtetë Kosova dhe Shqipëria ishin vendet e vetme në EJL që në vitin 2009 shënuan rritje pozitive të BPV-së. Megjithëkëtë, rritja ishte modeste, e ndrydhur nga një klimë në përkeqësim për investime, rënie të investimeve direkte nga jashtë, qeverisje dhe sundimit të dobët të ligjit dhe sjellje kriminale në rritje (World Bank 2010). Remitencat që vijnë nga popullata e madhe që jeton jashtë vendit me fillimin e krizës poashtu shënoi ulje. Andaj, Kosova mbetet vendi më i varfër në Evropën Jug-Lindore. Në vitin 2009 BPVja e Kosovës për kokë banori prej 1,760 € (World Bank 2010) është më e ulëta në EJL sipas margjinës së gjerë, dhe e vendos atë si një nga vendet më të varfëra në mbarë Evropën. Përmirësimi i tablosë së punësimit është çështje kyçe në zvogëlimin e varfërisë dhe në ngritjen e standardeve jetësore përmes një rritjeje më të shpejtë dhe më përfshirëse. Shkalla papunësisë së Kosovës, sipas Sondazhit të Fuqisë Punëtore (Enti Statistikor i Kosovës 2010) në vitin 2009 vlerësohet në jetë 46 për qind kurse 48 për qind sipas një Memorandumi Ekonomik të Vendit të zhvilluar së fundmi nga Banka Botërore (World Bank 2010). Shkalla e punësimit është vetëm 26 për qind (World Bank 2010). Krijimi i vendeve të punës është edhe më i rëndësishëm sepse popullata e Kosovës është e re në krahasim me vendet e tjera në rajon. Afërsisht gjysma e popullsisë së Kosovës është më e re se 24 vjeçare dhe vetëm 6 për qind e popullatës është më e vjetër se 65 vjeç.

Ky shënim ofron azhurnim të vlerësimit të varfërisë për Republikën e Kosovës të botuar në vitin 2007. Ky ka për qëllim të jetë përmbledhje koncize dhe me kohë dhe që nënvizon aspektet kyçe të varfërisë në Kosovë e jo të shërbejë si një analizë gjithëpërfshirëse për varfërinë dhe përcaktuesit e saj. Qasja pasqyron një lëvizje më të gjerë në punën analitike të Bankës Botërore mbi varfërinë në Ballkanin Perëndimor duke vendosur një theks më të madh në azhurnimet më të shkurtra dhe më të shpeshta sapo që të dhënat të jenë në dispozicion. Ky azhurnim mbi varfërinë bazohet në Sondazhin mbi Buxhetin Familjar (SBF) të zhvilluar në vitin 2009.

Vlerësimet e reja mbi varfërinë dhe profili në këtë azhurnim nuk janë drejtpërsëdrejti të krahasueshme me vitet e mëparshme. Miratimi i një mostre të re master për ABEF 2009 ngatërron krahasimet me raundet e mëparshme të SBF të cilat ishin të bazuara në kornizën e mostrave gjithnjë e më të vjetruara që nga regjistrimi i popullsisë së vitit 1981. Shih Kutinë 1 për më shumë detaje lidhur me çështjet e krahasueshmërisë së SBF-së me kalimin e kohës. Ky raport duhet të konsiderohet si një moment i varfërisë në Kosovë e jo si treguese e trendeve me kalimin e kohës.

Ky raport është i organizuar si në vijim. Seksioni 2 paraqet vlerësimet e varfërisë konsumuese në nivelet shtetërore dhe rajonale dhe gjithashtu përshkruan se si pabarazia ka ndikuar në shkallën e varfërisë në Kosovë. Seksioni 3 parashton një profil të detajizuar të varfërisë duke ekzaminuar se si varfëria lidhet me karakteristikat e shumta individuale dhe familjare. Seksioni 4 ofron një përmbledhje të shkurtër mbi gjetjen si dhe pjesën përmblylëse.

Kutia 1: Vlerësimet e varfërisë në Kosovë nuk janë të krahasueshme përgjatë viteve

Trendet konkluduese të mbështetura nga vitet njëpasnjëshme të të dhënave të ABEF në Kosovë janë dëshmuar si problematike për shkak të ndryshimeve të shpeshta në dizajnin e sondazhit dhe si pasojë e pasigurisë lidhur me margjinën e gabimit. Vëllimi II i Vlerësimit të Varfërisë 2007 ofron një analizë të detajuar të sfidave të krahasimit të sondazheve gjatë viteve në Kosovë (World Bank 2007b). Vlerësimi për Varfërinë kishte vërejtur se rezultatet e sondazhit e Studimit të Matjes së Standardeve Jetësore (SMSJ) në vitin 2000 dhe nga SBF-ja pasuese nga 2002 deri më 2005 nuk përputheshin për shkak të (a) ndryshimeve në SBF nga një ditë dyjavore në rikthim të javor të pyetjeve mbi konsumin, (b) ndryshimit të përkufizimeve të gjerave të konsumit përgjatë rraundeve të njëpasnjëshme të ABEF, dhe (c) dallimet ndërmjet SMSJ dhe SBF lidhur me sezonin(ët) që mbulohen, rikthim të periudhave për konsum dhe një listë e gjatë e gjërave të konsumit. Krahasueshmëria e problemeve që del nga këto ndryshime në dizajnin dhe implementimin e sondazheve të ekonomive familjare përbëhen nga përdorimi i një mase të vjetërsuar të mostrës e cila sipas SBF 2008 bazohej në regjistrimin e popullsisë së vitit 1981. Korniza e vjetërsuar e mostrës dhe mbikëqyrja e kufizuar e në terren çoi drejt pasigurisë së konsiderueshme lidhur me përshtatshmërinë e peshës së mostrës e që rezultoi në trende statistikore në të dhënat themelore demografike të cilat ishte e vështirë të pajtoheshin me realitetin dhe duke hedhur kështu dyshime mbi përfaqësueshmërinë e mostrave.

Vështirësitë ngjashme paraqiten edhe në krahasimin e SBF të vitit 2009 dhe krahasime të tilla duhet të kryhen me kujdes dhe në rastin më të mirë të konsiderohen si tregues. Në përpjekje për të tejkaluar kornizën në rritje të mostrës mos-përfaqësuese, në vitin 2008 u krijua një “mostër master” e re e bazuar në një listë të re banimi në zonat të caktuara. Mostra e re master – e cila është zhvilluar dhe përpunuar - besohet se ofron më mostra më shumë përfaqësuese duke shërbyer kështu si një zgjidhje e përkohshme deri në regjistrimin e ardhshëm të popullsisë – që është caktuar për në prill të vitit 2011. Fatkeqësisht, një çmim për këtë përmirësim në përfaqësueshmëri është humbja e krahasueshmërisë. Për shkak të ndryshimit në marrje të mostrave, rezultatet nga ABEF 2009 nuk duhet të krahasohen drejtpërsëdrejti me rezultatet nga vitet e mëparshme të ABEF apo Vlerësimit të Varfërisë. Kjo është e vlefshme megjithëse nuk ka pasur ndryshime të mëdha në dizajnin e ABEF apo implementimit në vitin 2009, si dhe metoda identike janë përdorur për llogaritjen e konsumit dhe varfërisë.

Ndryshimet e reja dhe të mëdha në kornizën e mostrës të ABEF 2009 ngatërrojnë krahasimet me rraundet e mëparshme të SBF. Dallimet përgjatë viteve të vëzhguara mund të jenë si shkak të ndryshimeve reale në terren apo sepse SBF 2009 përfaqësonte popullatën më shumë sesa sondazhet e tjera. Kjo vlen jo vetëm për nivelin e gjithëmbarshtëm të varfërisë por edhe për profilin e varfërisë. Sipas të gjitha gjasave që të dy këta faktorë janë përgjegjës për dallimet e vëzhguara, së bashku me kontribuuesit e tyre relativë të panjohur. Andaj, të gjetura në këtë raport më së miri interpretohen si *azhurnim i të kuptuarit tonë të varfërisë dhe mirëqenies në Kosovë*, dhe jo si tregues të rrethave me kalimin e kohës.

2. Nivelet e varfërisë dhe ndryshimet

2.1 Konceptet dhe përkufizimet

Siç është edhe rasti me analizat e mëparshme të Bankës Botërore mbi varfërinë në Kosovë, ky raport fokusohet në *varfërinë absolute*. Kjo do të thotë se krahason standardet jetësore kundrejt një pragu të varfërisë që mbahet i palëvizur në kushtet reale në kohë dhe hapësirë. Linja e varfërisë azhurnohet me kalimin e kohës për të llogaritur ndryshimet në çmime ashtu që të mjaftojnë në fitimin e të njëjtës pakoje të ushqimeve themelore dhe nevojave jo-ushqimore. Qasja e varfërisë absolute dallon nga qasja *varfëri relative* që përdoret nga pjesa më e madhe e Evropës e në

veçanti nga Bashkimi Evropian. Sipas qasjes se varfërisë relative pragu i varfërisë rritet me rritjen e të ardhurave mesatare të shtetit dhe së këndejmi nuk është e themeluar në kushte reale. Nëse të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet do të dyfishoheshin (pas llogaritjes së inflacionit) do të kishte një ulje substanciale të varfërisë absolute përdërisa varfëria do të mbetet tërësisht e pandryshuar. Qasja absolute dhe relative e varfërisë në këtë kohë është më e dobishme për Kosovën si shtet¹ me të ardhura mesatare të ulëta me një ndarje substanciale të popullatës që akoma lufton të përmbushë nevojat themelore të konsumit.

Në këtë raport konsumi është përdorur si masa e mirëqenies apo pasurisë individuale. Konsumimi për ekonomi familjare llogaritet si vlera e tërësishtme e shpenzimeve të ekonomisë familjare në gjëra ushqimore dhe jo-ushqimore siç jepet në SBF, përfshirë vlerësimin e çfarëdo ushqimi të prodhuar në shtëpi dhe që është konsumuar nga familja. Duke iu përmbajtur praktikave të kaluara në Kosovë, shpenzimet e konsumatorit në gjërat jetëgjata dhe në qira janë të përjashtuara nga masa e konsumit. Përshtatshmëria e një vlere të dhënë të konsumit të një ekonomie familjare varet nga madhësia dhe përbërja demografike e ekonomisë familjare ashtu që konsumi i ekonomisë familjare pjesëtohet me numrin e ekuivalenteve të të rriturve në familje për të arritur masën e mirëqenies që është konsumi për ekuivalentin për të rritur i shprehur në Euro në çmimet e vitit 2009. Për arsye të ndryshme, konsumi preferohet kundrejt masave monetare siç janë të ardhurat. Në përgjithësi konsumi është një tregues më i mirë i mirëqenies aktuale pasi që pasqyron përpjekjet e ekonomisë familjare për të zbutur ndryshimet në të ardhura. Personat që iu përgjigjën sondazhit gjatë vitit shpesh përfshihen në aktivitete shumë burimore që sjellin të ardhura, dhe procesi i rikthimit apo organizimit të kostove mund të jetë i vështirë e veçanërisht në rrethana të ekonomisë së madhe jo formale siç është rasti me Kosovën. Në rrethana të tillë personat në sondazh po ashtu janë më të disponueshëm të raportojnë shpenzimet sesa të ardhurat.

Në njohim qartazi se varfëria është një koncept shumëdimensional dhe që masat monetare siç është konsumi vetëm se prekin një nga këto dimensione, ndonëse një të një rëndësi tejet të madhe. Në mënyrë ideale, profile i varfërisë konsumuese të paraqitur në këtë raport duhet të implementohet nga analiza e dimensioneve të tjera të varfërisë dhe shkeljes, siç është mungesa e qasjes në shërbime publike, kushte të sigurta jetese, zë politik, tregu i punës dhe i produkteve si dhe aspekte të tjera të kushteve jetësore. Këto dimensioneve adresohen në raporte të tjera të Bankës Botërore sikurse edhe në dokumentet nga partnerët e tjerë të zhvillimit siç është Raporti i UNDP-së në Kosovë për Zhvillimin Njerëzor që fokusohet në përfshirjen shoqërore (UNDP 2011).

Në këtë analizë janë përdorur dy linja të varfërisë, siç vijon: një *linjë varfërie* që konsiderohet adekuate për të përmbushur nevojat themelore dhe një *linjë e varfërisë së skajshme* më e ulët. Të dyja linjat e varfërisë janë të bazuara në linjat e varfërisë që ishin llogaritur më herët në vlerësimin e varfërisë (World Bank 2005)² Pas përshtatjes për inflacionin, linjat e varfërisë dhe varfërisë së skajshme janë 1.55 € dhe 1.02 € për ekuivalente për të rritur për ditë (duke përdorur çmimet e vitit

¹ Grupi nga Banka Botërore sipas të ardhurave përmban katër kategori bazuar në të hyrat bruto për kokë banori (World Bank Atlas method). Në çmimet e vitit 2009 kategoritë janë të ardhura të ulëta (995 USD ose më pak), të ardhura mesatare të ulëta (996 – 3,954 USD), të ardhura mesatare të larta (3,946-12,195 USD), dhe të ardhura të larta (12,196 e më lartë).

² Linjat e varfërisë së Kosovës janë themeluar duke përdorur metodën e Kostos së Nevojës Bazike (Ravallion 1994). Komponenti i ushqimit i linjës së varfërisë nisët nga marrja kalorike prej 2,100 kilo-kalori për person në ditë, bazuar në modelin e konsumit mesatar të ekonomisë familjare afër lindës së varfërisë. Komponenti jo-ushqimor i linjës së varfërisë bazohet në shpërndarjen e shpenzimeve totale që ndajnë ekonominë e varfra në gjërat jo-ushqimore. Linja e varfërisë është shuma e komponentëve ushqimore dhe jo-ushqimore. Linja e varfërisë së skajshme vendoset baras me linjën e varfërisë që do të thotë se një ekonomi që është skajshmërisht e varfër ka nivel të konsumit më të ulët sesa sasia që kërkohet për të arritur referencën e varfërisë së shportës së ushqimit.

2009).³ Të dy masat e varfërisë në konsum të përdorura në këtë raport paraqesin shkallën e varfërisë për kokë banori dhe zbrazëtirën e varfërisë. Shkalla e varfërisë për person mat se sa njerëz janë të varfër dhe paraqet thjesht përqindjen e popullatës konsumi i ekuivalentit për të rritur të cilëve është më i ulët sesa linja e caktuar e varfërisë. Zbrazëtira e varfërisë mat jo vetëm se sa njerëz janë të varfër por edhe *thellësinë* e varfërisë në mes të të varfërve, dhe rrjedhimisht, mund të zbulojë ndryshimet në mirëqenien që zhvillohet nën linjën e varfërisë, siç është rasti ekonomitë familjare bëhen më pak të varfra por jo aq sat ë kalojnë linjën e varfërisë. Zbrazëtira e varfërisë mund të llogaritet si prodhimi i HC ku H paraqet shkallën për person dhe C paraqet “zbrazëtirën konsumuese,” që është dallimi në mes të linjës së varfërisë dhe mesatares së nivelit të konsumit të ekonomive të varfra familjare që shprehura si përpjesëtim i linjës së varfërisë.

2.2 Profili gjeografik i varfërisë

Bazuar në ABEF 2009 vlerësohet se 34.5 për qind të popullsisë së Kosovës jeton nën linjën e varfërisë kurse 12.1 për qind të popullsisë jetojnë nën linjën e varfërisë së skajshme (Figura 1). Siç është shpjeguar në prezantim, rezultatet nga viti 2009 nuk janë në mënyrë strikte të krahasueshme me rezultatet nga sondazhet e mëparshme për shkak të dallimeve të mëdha në kornizat e mostrave në të dy sondazhet. Përgjatë një numri të sondazheve jo të krahasueshme varfëria për banor ka lëvizur ndërmjet 30 për qind dhe 40 për qind (World Bank 2007a).⁴ Pasi përmendëm këtë, dallimi në shkallën e varfërisë ndërmjet vitit 2005-06 dhe 2009 në përgjithësi është në përputhje me rritjen e BPV-së së Kosovës për atë periudhë e cila përkundër krizës ekonomike të vitit 2009 ka qenë modeste por e qëndrueshme.⁵


Shkallët e varfërisë në vitin 2009 janë pothuajse të njëjta në zonat urbane dhe rurale – varfëria është diçka më e lartë në zonat rurale derisa varfëria e skajshme është diçka më e lartë në zonat urbane. Sikurse shkalla e gjithëmbarshme e varfërisë, dallimi në varfërinë rurale-urbane a ndryshuar në masë të gjerë në sondazhet e njëpasnjëshme jot ë krahasueshme, nga 12 përqind më e lartë në zonat urbane në vitin 2002-03 në 12 përqind në zonat rurale në vitet 2005-06 (World Bank 2007b). Megjithëse nuk është e mundur të veçohen shkaqet e mundshme, është e qartë se varfëria në vitin 2009 është fenomen sa urban aq edhe rural.

³ IQK nga Përmbledhja Ekonomike Botërore (World Economic Outlook) të FMN-së është përdorur për të rritur linjën e varfërisë në vlerat e vitit 2009. Vlerësimet alternative që përdorin IQK-në nga Enti i Statistikave të Kosovës nxjerr linja varfërie pothuajse identike.

⁴ Varfëria për kokë banori e raportuar në vlerësimet e viteve të mëparshme është 37.7 në vitet 2002–03, 43.7 në vitet 2003–04, 34.8 në vitet 2004–05, dhe 45.1 në vitet 2005–06.

⁵ GDP u rrit për 20.6 për qind ndërmjet viteve 2005–06 dhe 2009, dhe 13.1 për qind në termat për kohë banori (World Bank 2010). Një ndryshim në shkallën e varfërisë prej 45.1 në 34.5% është zvogëlim prej 23.5 për qind që nënkupton elasticitetin e rritjes së varfërisë prej -1.8, që është brenda asaj që është vëzhguar për vendet tjera (Ravallion 2001). Po ashtu, mbani mend që edhe pse anketa dhe llogaritë kombëtare për konsumin dallojnë në mënyrë tipike (Ravallion 2003), përllogaritja e rritjes së konsumit për kokë banori ndërmjet dy anketave (7.6 për qind) është afër me përllogaritjet përkatëse nga llogaritë kombëtare (11.3 për qind).


Figura 1: Varfëria dhe varfëria e skajshme për banor, 2009



Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009

Thellësia e varfërisë – sipas matjes së indeksit të zbrazëtirës së varfërisë – dhe varfëria e skajshme në vitin 2009 janë pothuajse të barabarta në zonat rurale dhe urbane ku nivelet e varfërisë janë pak më të larta në zonat urbane (Figura 2). Në vitin 2009 niveli i konsumit të një personi të varfër ishte 72.2 për qind të linjës së varfërisë. Figura korresponduese për ata që janë nën linjën e varfërisë së skajshme është 77.7 për qind.


Figura 2: Indeksi i zbrazëtirës së varfërisë për linjën e varfërisë së plotë dhe asaj të skajshme, 2009



Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009

Vlerësimi i shkallës së varfërisë rurale dhe urbane ndryshon varësisht nëse zgjedhet linja e varfërisë së plotë apo varfërisë së skajshme. Kjo ilustron në mënyrë më të përgjithshme për një shkallë të gjerë të linjave të varfërisë në Figurën 3. Kurbat janë funksionet empirike të densitetit kumulativ (FDK) të konsumit për ekuivalentin për të rritur që gjithashtu njihen si kurbat e paraqitjes së varfërisë. Linja vertikale në qendër të figurës është linja e varfërisë së skajshme (1.02 € në ditë) dhe në të djathtë të saj është linja e varfërisë së plotë (1.55 € në ditë). Kësisoj mund të lexohet shkallën e varfërisë për banor nga boshti vertikal, varësisht së ku kryqëzohen linjat e varfërisë në FDK. Nga Figura 2 mund të shihet se për shumicën e linjave të varfërisë nën 1.35 € në ditë shkalla varfërisë për person në zonat urbane është pak më e lartë sesa në zonat rurale. Anasjelltas, për linjat e varfërisë më të larta sesa 1.35 € në ditë shkalla për person është më e lartë në zonat rurale ku dallimi rritet në masë të konsiderueshme derisa personi lëviz në linjat e varfërisë së 2.00 € e më lartë në ditë.

Figura 3: Sensitiviteti i niveleve të varfërisë rurale-urbane sipas linjës së varfërisë, 2009



Shkallët e varfërisë përgjatë shtatë rajoneve të Kosovës dallojnë shumë, siç e tregon edhe Tabela 1. Sipas ABEF 2009, shkalla varfërisë për banor ndryshon nga më e larta prej 54 për qind në Ferizaj dhe Gjakovë tek 18 për qind në Gjiçan. Zbrazëtira e varfërisë dhe masat e varfërisë duke përdorur linjën e varfërisë së skajshme tregojnë hapësira ngjashmërisht të gjëra dhe shkallë relativisht konsistente të rajoneve përgjatë masave të ndryshme. Profili rajonal i varfërisë në vitin 2009 ka disa dallime të mëdha nga profilet rajonale të viteve 2005-06. Pritet që disa nga ndryshimet në vlerësimet e varfërisë rajonale i atribuohen përdorimit të mostrës së re master në vitin 2009, veçanërisht sepse masat më të vogla të mostrave në nivelin rajonal nënkuptojnë se vlerësimet nga cilido sondazh i vetëm është më pak i saktë.

Tabela 1: Varfëria dhe varfëria e skajshme sipas rajonit, 2009

Rajoni	Linja e varfërisë së plotë		Linja e varfërisë së skajshme	
	Për person	Zbrazëtira e varfërisë	Për person	Zbrazëtira e varfërisë
Ferizaji	53.8	14.6	17.7	3.7
Gjakova	54.0	16.3	22.4	5.9
Gjilani	18.0	3.8	3.6	0.9
Mitrovica	38.0	12.2	17.0	4.2
Peja	37.2	10.9	13.1	3.8
Prishtina	21.8	6.2	9.0	1.3
Prizreni	33.9	7.6	6.8	1.0
Gjithsej	34.5	9.6	12.1	2.7

Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009

Megjithëse shkalla e varfërisë rurale dhe urbane në Kosovë në vitin 2009 ishte pothuajse e barabartë, afër dy të tretat e njerëzve të varfër jetojnë në zona rurale, thjesht sepse Kosova është kryesisht rurale. Kombinon informacion mbi shkallën e varfërisë me shpërndarjen gjeografike të popullatës për të treguar cilat zona kanë numër më të madh apo më të vogël të njerëzve të varfër. Në linjën e varfërisë së plotë shfaqen numra mjaft të barabartë të personave që jetojnë në pesë nga shtatë rajonet (Ferizaji, Gjakova, Gjilani, Mitrovica, Prishtina, dhe Prizreni) ku secila përmban 16 deri 17 për qind të të varfërve të Kosovës. Pjesa e mbetur prej 17 për qind ndahet ndërmjet Pejës (11.0 për qind) dhe Gjilanit (5.8 për qind). Varfëria e skajshme në vitin 2009 është më e përqendruar gjeografikisht. Si Gjakova ashtu edhe Mitrovica përmbajnë më shumë se 20 për qind të popullatës në varfëri të skajshme dhe Prishtina përmban pothuajse sa edhe këto qytete (18.7 për qind). Në kontrast, Gjilani, Peja dhe Prizreni së bashku llogarisin vetëm 23.4 për qind të popullatës në varfëri të skajshme.

Tabela 2: Shpërndarja e të varfërve, 2009

Zona/Rajoni	Shpërndarja e popullatës		Shpërndarja e të varfërve	
	Shpërndarja e popullatës	Shpërndarja e të varfërve	Shpërndarja e të varfërve	Shpërndarja e varfërisë së skajshme
Urbane	49.8	35.6	39.8	39.8
Rurale	50.3	64.4	60.2	60.2
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0
Ferizaji	20.0	17.1	16.0	16.0
Gjakova	19.6	17.3	20.4	20.4
Gjilani	6.8	5.8	3.3	3.3
Mitrovica	15.3	16.8	21.4	21.4
Peja	14.0	11.1	11.0	11.0
Prishtina	10.6	15.9	18.7	18.7
Prizreni	13.8	16.0	9.1	9.1
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009

2.3 Pabarazia

Në përgjithësi pabarazia në Kosovë është relativisht e ulët. Tabela 3 paraqet një rreshtin të masave të pabarazisë në nivel shtetëror dhe ndarjen sipas zonës së banimit rurale-urbane dhe zonave rajonale. Secili nga treguesit e pabarazisë vendos peshë të madhe mbi pabarazinë në pjesë të ndryshme të shpërndarjes së konsumit. Koefficienti Gini është statistika me përdorimin më të gjerë për pabarazinë dhe i jep më shumë peshë pabarazisë rreth mesatares së shpërndarjes. Masa e Entropisë së Përgjithësuar (EP) është tregues i parametrizuar ku vlerat më të ulëta të parametrizimit caktojnë peshë më

të madhe të pabarazisë në pjesët më të varfra të shpërndarjes dhe vlera më të larta të parametrin që cakton peshë më të madhe pabarazisë në pjesët më të pasura të shpërndarjes.⁶

Pabarazia e konsumit është në masë të konsiderueshme më e lartë në zona urbane sesa në ato rurale. Kjo gjetje është e përbashkët në mbarë botën. Të gjitha katër masat e pabarazisë të raportuara në Tabelën 3 janë konsistente në shfaqjen e pabarazisë më të lartë në zonat urbane dhe pabarazisë më të ulët brenda zonave rurale. Në mesin e rajoneve, Mitrovica, Prishtina dhe Gjakova kanë nivelet më të mëdha të pabarazisë së konsumit, derisa Prizreni dhe Ferizaji kanë nivelin më të ulët.

Tabela 3: Treguesit e pabarazisë, 2009

Zona/Rajoni	Gini	GE(-1)	GE(0)	GE(1)
Urbane	33.9	22.3	19.0	19.7
Rurale	27.2	14.2	12.4	12.7
Ferizaji	24.4	11.0	10.0	10.4
Gjakova	29.2	16.8	14.4	14.7
Gjilani	25.5	12.1	10.9	11.6
Mitrovica	32.4	20.3	17.4	17.6
Peja	28.0	16.4	13.5	13.0
Prishtina	31.4	19.5	16.7	17.0
Prizreni	19.1	6.6	6.1	6.0
Gjithsej	30.2	17.3	15.2	15.9

Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009

2.4 Varfëria relative

Megjithëse ky raport fokusohet në varfërinë absolute, prapëseprapë është e udhës të ekzaminohen ndryshimet në varfërinë relative e cila në fakt është një masë tjetër e pabarazisë. Ndryshe nga linjat e varfërisë absolute, vlera reale e linjës së varfërisë relative – që është minimumi i pranueshëm i standardit jetësor – ndryshon me kalimin e kohës në vend se të mbetet i pandryshuar. Standardi i Eurostat-it për “rezikun e varfërisë” është 60 për qind të të ardhurave mesatare në shkallë vendi të cilën ne këtu e përshtatim që konsumi të arrijë në një nivel ditor të linjës së varfërisë në 1.13 € për ekuivalentin për të rritur në vitin 2009. Vëreni se kjo është konsiderueshëm më pak sesa linja e varfërisë absolute e përdorur në pjesën tjetër të raportit dhe korrespondon me një standard jetese shumë më të afërt linjës së varfërisë absolute të skajshme prej 1.02 € në ditë. Në këtë linjë varfërie, si varfëria për banor ashtu edhe zbrazëtira e varfërisë janë më të larta në zonat urbane sesa në ato rurale.

Tabela 4: Varfëria relative, 2009

	Shkalla e varfërisë për banor	Zbrazëtira e varfërisë
Urbane	17.1	4.1
Rurale	16.1	3.7
Gjithsej	16.4	3.8

Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009

⁶ Kur parametri është zero (GE(0)) indeksi është i njohur si indeksi mesatar i devijimit të logut, ose Theil L. Kur parametri është zero (GE(1)) indeksi është i njohur edhe si indeksi Theil T.

3. Profili i varfërisë sipas ekonomisë familjare dhe karakteristikave individuale

Ky seksion ekzaminon në dy mënyra se si lidhet varfëria me ekonominë familjare dhe karakteristikat individuale. Njëra mënyrë është duke krahasuar shkallët e varfërisë përgjatë nën-grupeve të ndryshme të popullsisë e cila na tregon gjasat që dikujt t'i jepen karakteristika të caktuara të dobëta siç janë moshë, gjinia apo statusi i punësimit. Mënyra e dytë përshkruan karakteristikat e atyre që janë nën linjën e varfërisë. Për shembull, *shkalla* e varfërisë për të rritur të cilët nuk kanë mbaruar as edhe shkollën fillore është shumë e lartë. Megjithatë, individët e tillë përbëjnë një pjesë të vogël të popullsisë së gjithëmbarshme dhe poashtu një pjesë të vogël të popullsisë së varfër. Duke shikuar këto dy perspektiva së bashku mund të shohim jo vetëm se cilat grupe kanë më së shumti mundësi të jenë të varfra por gjithashtu edhe cilat grupe përbëjnë përpjesëtim të madh të popullsisë së varfër e që të cilat jo gjithmonë janë e njëjta gjë.

Një kufizim në analizën e karakteristikave individuale është se statusi i varfërisë përcaktohet në nivel të ekonomive familjare, në bazë të konsumit të ekonomive familjare të ndarë në numrin e numrit ekuivalent të të rriturve në ekonominë familjare. Sikur edhe shumica e anketave të ekonomive familjare, ABF nuk mbledh të dhëna të mjaftueshme dhe të hollësishme për konsumin në nivel individual për të standardet e ndryshme të jetës brenda individëve që jetojnë në të njëjtën ekonomi familjare, edhe pse nuk ka dyshim për ekzistimin e dallimeve të tilla. Ndikimi i këtij kufizimi është që analiza e varfërisë nga karakteristikat individuale nuk është aq e ndjeshme për dallimet përgjatë grupeve si do të ishte nëse do të kishim në dispozicion të dhënat për nivelin e konsumit në nivel individual.


3.1 Karakteristikat socio-demografike

Rinia e Kosovës janë të varfër në mënyrë joproportionale. Kosova ka një popullatë jashtëzakonisht të re për standardet Evropiane, dhe llogaritet se një e treta janë nën 15 vjet, dhe gjysma nën 24 vjet. Paneli i majtë i figurës 4 tregon se shkallët e varfërisë janë më lartat tek të rinjtë nën moshën 20 vjeçare dhe pastaj bie lehtë për t'u rritur prapë te të moshuarit.

Pasi të rinjtë kanë shkallë të lartë të varfërisë dhe përbëjnë një pjesë të madhe të popullatës së përgjithshme, atëherë ata përbëjnë një pjesë të madhe të popullatës së varfër. Paneli i djathtë i figurës 4 tregon përbërjen e popullatës së varfër në bazë të grupmoshave (zona e hijezuar) në krahasim me përbërjen e tërë popullatës. Në vitin 2009, më shumë se 40 për qind të të varfërve ishin nën moshën 20 vjeçare dhe 60 për qind nën moshën 30 vjeçare. Kjo krahasohet me 38 dhe 56 për qind të popullatës totale në ato grupmosha. Ofrimi i arsimit adekuat dhe mundësive të punësimit për këtë segment të madhe dhe vazhdimisht në rritje të popullatës është një sfidë e madhe me të cilën ballafaqohet Kosova tani dhe në aspektin afatmesëm.


Personat që jetojnë në ekonomitë familjare me kryefamiljare femër kanë tendencë më të madhe të varfërisë sesa ato me kryefamiljar mashkull. Figura 5 tregon relacionin ndërmjet gjinisë dhe varfërisë. Ana e majtë paraqet varfërinë për meshkuj dhe femra nga ABEF 2009 që tregon se shkalla e varfërisë është më e lartë për një për qind të femrat sesa të meshkujt. Ana e djathtë tregon shkallët e llogaritjes së varfërisë në bazë të gjinisë së kryefamiljarit. Sipas ABEF 2009, afërsisht pesë për qind të popullatës jetojnë në ekonomi familjare të udhëhequra nga femrat dhe varfëria është 3 për qind më e lartë në ato ekonomi familjare sesa ato të udhëhequra nga meshkujt.

Figura 4: Prania e varfërisë në bazë të grupmoshave (paneli i majtë) dhe shpërndarja e të varfërve dhe popullatës së tërë në bazë të grupmoshave (paneli i djathtë) 2009



Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009


Figura 5: Prania e varfërisë në bazë të gjinisë dhe gjinisë së kryefamiljarit, 2009



Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009

Ekonomitë familjare të mëdha kanë tendencë më të madhe të varfërisë dh përbëjnë një pjesë të madhe të popullatës së varfër. Ekonomitë familjare në Kosovë janë më të mëdha sesa ato të vendeve evropiane, me përfaqësim gjatë persona. Siç shihet në panelin e majtë të figurës 6, shkallët e varfërisë janë më të lartat për ekonomitë familjare të mëdha. Rreth 11 për qind të ekonomive familjare në Kosovë kanë 10 ose më shumë persona, që përbëjnë rreth 23 për qind të popullatës. Pra, duke marrë parasysh shkallët e larta të varfërisë nuk është befasi që rreth një e katërta e të varfërve jetojnë në ekonomi familjare prej dhjetë ose më shumë njerëzve, siç mund të shihet edhe në panelin e djathtë të figurës 6. Pjesë substanciale të njerëzve të varfër jetojnë në ekonomi familjare prej pesë deri në shtatë persona.

Figura 6: Shpeshhtësia e varfërisë dhe shpërndarja në bazë të madhësisë së ekonomisë familjare, 2009



Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009

3.2 Statusi ekonomik dhe i punësimit

Varfëria në konsum është i lidhur ngushtë me aktivitetet ekonomike të ekonomisë familjare, në veçanti statusi i punësimit, dhe nëse i punësuar nga sektori dhe lloji i punësimit. Po ashtu, statusi i punësimit dhe të ardhurat janë të ndikuara fuqishëm nga niveli i arsimit të personit pasi që ata me nivele të larta të arsimit kanë gjasa më të mëdha që të gjejnë punësim dhe të qenë qasje në punë që paguhet më shumë.

Nuk është befasuese që shkallët e varfërisë janë më të lartat tek ata burimi i të ardhurave të cilëve është ndihma sociale. ABEF i ka pyetur ekonomitë familjare se cili është burimi i ardhurave të tyre dhe përgjigjet janë përmbledhur në Tabelën 5. Shumica e përfutuesve nga pagesat e ndihmës sociale zvogëlojnë nivelin e varfërisë së tyre, por janë të pamjaftueshme për t'i ngritur mbi linjën e varfërisë. Grupet tjera me mesatare më të lartë sesa shkallët e varfërisë janë ekonomitë familjare që varen nga punësimi i kohëpaskohshëm (puna me ditë) dhe ata që varen nga pensionet. Pensioni standard është 45 euro në muaj dhe është pothuaj i barabartë me linjën e varfërisë prej 46.50 euro, ndërsa pensionistët kontribuues marrin më shumë. Prandaj, ekonomitë familjare që përbëhen vetëm nga pensionistët nuk janë të varfër, por ata në ekonomi familjare më të mëdha pa burime tjera të konsiderueshme me gjasë janë të varfra për shkak se pensionet e tyre nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur familjet e tyre. Një implikim i kësaj është se mënyra më efektive për të zvogëluar varfërinë tek pensionistët nuk është përmes rritjes së pensioneve, por përmes përmirësimit të mundësive të fitimit të të ardhurave të popullatës në moshë të punës.

Shkallët e varfërisë janë më të ulëta tek ekonomitë familjare që varen parimisht nga paratë e dërguara (remitancat) nga jashtë, punësimin në sektorin publik dhe bizneset e ekonomive familjare (vetë-punësimi). Migrimi i jashtëm për punë nga Kosova ka qenë i lartë tradicionalisht me destinacion kryesor në Gjermani dhe Zvicër. Llogaritjet që në vitin 2009 paratë e dërguara nga migrantët kanë arritur rreth 500 milion euro, duke i bërë kështu paratë e dërguara burimin kryesor të jashtëm të të ardhurave, duke arritur në 13 deri në 15 për qind të BPV-së totale (Banka Botërore 2010). Sipas ABEF 2009, 14 për qind të ekonomive familjare pranojnë para të dërguara nga jashtë në mesatare prej 316 euro në muaj tek ekonomitë familjare pranuese, edhe pse mesatarja është vetëm 200 në muaj. Edhe pse ekonomitë familjare që pranojnë para të dërguara kanë gjasa më të vogla që të jenë të varfër, shkalla e cila i atribuohet drejtpërdrejtë parave të dërguara nuk është e qartë. Të dhënat e ABEF tregojnë që shumica e ekonomive familjare jo të varfra që pranojnë

para të dërguara nuk do të ishin të varfëra edhe nëse nuk do të kishin para të dërguara, por po ashtu njihet gjerësisht që paratë e dërguara mund të jenë nën-llogaritur nga kjo anketë.

Afër 40 për qind të të varfërve jetojnë në ekonomi familjare burimi kryesor i të cilave janë pagat (Tabela 5). Kjo mund të jetë konsistente me nivelet e larta të papunësisë dhe nivelet e ulëta të punësisë të dhëna më sipër. Një ekonomi familjare mesatare në Kosovë ka gjashtë anëtarë, katër prej të cilëve janë të rritur. Në shumë raste, një ose dy anëtarë kanë punësim me pagë, por ajo e hyrë nuk është e mjaftueshme për t'i përmbushur nevojat e familjes, në veçanti nëse të rriturit tjerë nuk kanë punësim të rregullt. Po ashtu, është me rëndësi të potencohet se këto ekonomi familjare me shkallë të larta të papunësisë tek të rriturit nuk kanë të drejtë të përfitimit nga ndihma sociale sipas rregullave aktuale të sistemit, të cilat përjashtojnë ekonominë familjare në të cilat një person është i punësuar, pavarësisht se sa të rritur janë pjesë e ekonomisë familjare janë të punësuar.

Ky shpjegim është mbështetur me Tabelën Nr. 6 e cila jep informatat në nivel individual rreth relacionit ndërmjet varfërisë dhe aktivitetit kryesor të një personi, e kufizuar me personat nga 15 vjet e më shumë. Shkallët më të larta të varfërisë janë të pranishme te punonjësit me ditë dhe të papunësuarit. Nëse i kthehemi përbërjes së popullatës së varfër, ne shohim që afër 30 për qind të të rriturve të varfër janë të papunësuar.⁷ Në vitin 2009, aktivitetet kryesore të ardhshme dhe më të zakonshme tek të rriturit e varfër janë amvise (19 për qind), studentë (16 për qind) dhe të pensionuarit ose personat me aftësi të kufizuara (12 për qind).

Tabela 5: Varfëria dhe shpërndarja e të varfërve në bazë të burimit kryesor të të ardhurave të ekonomisë familjare 2009

Burimi kryesor i të ardhurave për ekonominë familjare	Shkalla e llogaritjes së varfërisë	Shpërndarja e të varfërve	Shpërndarja e popullatës
Pagat nga sektori publik	23.6	17.3	25.2
Pagat nga sektori privat	36.4	20.7	19.6
Bujqësia	36.3	8.2	7.8
Puna me ditë	55.2	17.5	10.9
Bizneset tjera të ekonomisë familjare	20.6	8.7	14.5
Pensionet	43.4	7.6	6.1
Paratë e dërguara nga jashtë	21.9	5.5	8.6
Paratë e dërguara tjera	32.9	0.3	0.3
Ndihma sociale	83.1	12.6	5.2
Tjera	32.5	1.6	1.7
Totali	34.5	100.0	100.0

Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009.

⁷ Shih Kutinë 2 për një përshkrim të karakteristikave të punëtorëve të papunë në Kosovë.


Tabela 6: Shpeshësia e varfërisë dhe shpërndarja e të varfërve në bazë të aktivitetit kryesor individual, 2009

Aktiviteti kryesor	Shkalla e llogaritjes së varfërisë	Shpërndarja e të varfërve	Shpërndarja e popullatës
	2009	2009	2009
Punëdhënës	6.9	0.2	0.8
I punësuar me pagë	20.5	10.1	16.2
Bujqësi për jetesë	33.0	3.4	3.4
Punëtorë me ditë	50.1	6.1	4.0
Të vetëpunësuar tjerë	20.1	2.0	3.2
Punëtorë familjar të papaguar	15.9	0.4	0.8
Nxënës/student	32.3	16.2	16.5
Pensionuar ose paaftë	32.3	11.8	12.0
Papunësuar	39.0	29.7	25.0
Amvis/e	35.8	18.8	17.2
Tjerë	48.1	1.5	1.0
Totali	32.8	100.0	100.0

Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009.

Të dhënat ndër-seksionale nga ABEF tregojnë një ndërlidhje të qartë ndërmjet arsimimit dhe varfërisë në Kosovë. Arsimiti është një prej rrugëve më të besueshme për të dal nga varfëria pasi që është e shoqëruar jo vetëm me qasje të përmirësuar në mundësi më të mira punësimi dhe shpesh produktivitet më të lartë në ato punë, por edhe me rritje të mirëqenies jashtë vendit të punës. Figura 7 tregon shkallët e varfërisë për individët 15 vjeçar ose më të mëdhenj në bazë të nivelit më të lartë të arsimit të kryer. Në të dy anketat, zvogëlimi i shkallëve të varfërisë rritet gjatë lëvizjes drejt shkollës së arsimimit. Pra, kryerja e shkollës fillor çon në rezultate më të mira të varfërisë sesa moskryerja e shkollës fillore, dhe përfitimi është më i madh duke lëvizur nga fillorja në shkollë të mesme të kryer, dhe më e madhe gjatë lëvizjes nga shkolla e mesme në arsim të lartë të kryer.

Figura 7: Llogaritja e varfërisë në bazë të nivelit më të lartë të arsimit të kryer, 2009



Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009.

Kutia 2: Kush është i papunësuar?

Siç është theksuar në hyrje, shkalla e papunësisë në Kosovë është afër 50 për qind, më e larta në Evropën Jug Lindore dhe një prej më të lartave kudo në Evropë. Rritja e mundësive të punësimit është esenciale për zvogëlimin e varfërisë në Kosovë dhe është po ashtu e rëndësishme të dihen grupet e fokusit për përpjekjet në krijimin e punësimit. Kjo kuti shfrytëzon të dhënat nga ABEF 2009 për të krijuar një profil të shkurt të të papunëve.

Tabela 6 për personat e varfër prej 15 vjet e më shumë, tregon se më shumë janë të papunësuar sesa asnjë kategori tjetër kryesore e dhënë në ABEF dhe me një margjinë të gjerë. Tabela më poshtë tregon se kjo është e vërtetë edhe për popullatën e rritur në përgjithësi. Në të vërtetë, **numri i të papunëve është gati po aq i madh sa të gjitha kategoritë e të punësuarave së bashku** (punëdhënës, punonjës me pagë, bujqësi për jetesë, të tjerë të vetëpunësuar, të punësuar me ditë dhe punëtor familjar pa pagesë).

	Total	Të papunë	Punonjës me pagë	Të punësuar tjerë*	Amvis/e
Pjesa e popullatës (17 vjet e më shumë)	100.0	26.3	17.2	12.9	18.3
Mosha mesatare (vitet)	40.1	32.5	39.6	38.5	44.1
Më pak se shkollim fillor (%)	13.7	4.0	0.5	3.9	19.7
Shkollim fillor të kryer (%)	38.2	40.1	9.7	35.9	33.9
Shkollim të mesëm të kryer (%)	42.6	51.4	74.5	56.8	13.8
Shkollim të lartë të kryer (%)	5.5	4.5	15.8	3.4	0.0
Femra (%)	50.5	59.6	23.7	5.5	99.8
Urban (%)	38.2	37.5	52.5	33.2	31.6
Madhësia e ekonomisë familjare (persona)	7.2	7.5	6.5	7.8	7.3
Ekonomitë familjare me kryefamiljar femër	5.6	6.2	4.7	3.9	6.0

*Shënim: "Të punësuar tjerë" përfshijnë punëdhënës, punonjës me pagë, bujqësi për jetesë, të tjerë të vetëpunësuar, të punësuar me ditë dhe punëtor familjar pa pagesë.

Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009.

Të papunët janë mjaft më të ri sesa të punësuarit, me një mesatare të moshës prej 32.5 vite, në krahasim me moshën 39.6 tek të të punësuarit me pagë dhe 38.5 për të punësuarit e tjerë. Pavarësisht edukimit më të lartë sesa popullsia e rritur në përgjithësi, **të papunët kanë më pas arsimin sesa punëtorët me pagë**, dhe pak më pak arsim sesa personat tjerë të punësuar. Tek të të papunët, 40 për qind kanë të kryer arsimin fillor, 51 për qind arsimin e mesëm dhe 4 për qind arsimin e lartë në krahasim me 10, 74 dhe 16 për qind tek të punësuarit me pagë.


Përafërsisht 60 për qind të të papunëve janë femra, ndërsa vetëm 24 për qind të punonjësve me pagë janë femra. Femrat përbëjnë një përqindje edhe më të vogël (6 për qind) të të punësuarve tjerë me pagë. Përqindja kaq e lartë e femrave të papunësuar është edhe më e theksuar kur të merret parasysh se po thuaj të gjithë amvisët/et janë femra, të cilat përbëjnë 18 për qind të popullatës (36 për qind të femrave). Sikur të kishte mundësi të përshtatshme punësimi në dispozicion dhe kushtet tjera të lejonin këtu, shumë prej femrave të cilat janë amvise do të donin të hyjnë në tregun e punës.

Sa i përket karakteristikave tjera, të papunësuarit janë shumë të ngjashëm me popullatën e përgjithshme me shkallë përafërsisht të barabarta me urbanizim, madhësinë e ekonomive familjare dhe përqindjet që jetojnë në ekonomitë familjare me kryefamiljar femër. Për dallim me këtë, ata që punojnë në pozita me pagë janë më shumë urban, vijnë nga ekonomi familjare më të vogla dhe kanë kryefamiljar mashkull.

Një perspektivë tjetër në arsimin dhe varfëri në bazë të ABEF 2009, është dhënë në figurën 8. Linja tregon të njëjtin relacion ndërmjet llogaritjes së varfërisë dhe nivelit të arsimimit sikur në figura paraprake. Shtyllat vertikale tregojnë se afërsisht 40 për qind të popullatës së rritur në Kosovë ka përfunduar vetëm shkollën fillore dhe një 40 për qindësh tjetër ka të kryer arsimin e mesëm ose profesional. Rreth 15 për qind nuk kanë kryer filloren dhe vetëm rreth pesë përlind kanë kryer arsimin e lartë. Kur të krahasohet me shpërndarjen e të varfërve (shtyllat e ndiçuara) në shpërndarjen e

popullatës së rritur në përgjithësi (shtyllat e mbyllta) është e qartë se ata me arsimim fillor ose më pak janë më të varfër në mënyrë joproporcionale dhe që rrjedhimisht ata me shkollë të mesme ose arsim të lartë kanë më pak gjasa për të qenë të varfër.

Figura 8: Varfëria dhe shpërndarja e të varfërve në bazë të nivelit më të lartë arsimor të kryer, 2009



Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009.

3.3 Profili i kushtëzuar i varfërisë

Seksionet paraprake kanë paraqitur atë që mund të quhet profili i “pakushtëzuar” i varfërisë, i cili përshkruan ndërlidhjet me dy variabla ndërmjet varfërisë dhe një individi të veçantë ose karakteristikës së ekonomisë familjare pa kontrolluar karakteristikat tjera. Për shembull, është theksuar se ekonomitë familjare me kryefamiljar femër janë më të varfra (figura 5) dhe se personat më të arsimuar kanë më pak gjasa të jenë të varfër (figura 8). Megjithatë, ekonomitë familjare me kryefamiljar femër kanë më pak arsimim mesatarisht sesa homologët e tyre meshkuj, prandaj nuk është e qartë nëse rezultati i varfërisë duhet t’i atribuohet arsimimit ose gjinisë apo të dyjave.

Në këtë seksion, ne paraqesin profilin e “kushtëzuar” të varfërisë përmes metodave ekonometrike për të ekzaminuar marrëdhënien ndërmjet një individi ose karakteristike të ekonomisë familjare dhe varfërisë, duke kontrolluar edhe karakteristika tjera. Seti i parë i analizës përdor modelet probit për të vlerësuar marrëdhënien ndërmjet ndryshimit në një karakteristikë dhe gjasat e të qenit nën linjën e varfërisë, por duke i mbajtur karakteristikat tjera konstante. Seti i dytë i analizës kap një pamje më të gjerë dhe shfrytëzon regresionin e katrorëve më të pakët të zakonshëm (KPZ), apo që në gjuhën profesionale njihet si OLS nga origjinali në anglisht, për të analizuar përqindjen e konsumit për ekuivalentin e të rriturit të shoqëruar me një ndryshim në një karakteristikë të dhënë, prapë duke mbajtur variablat tjera konstante. Përparësia kryesore e qasjes së parë është se tregon një lidhje të qartë ndërmjet karakteristikave dhe gjasave të të qenit nën linjën specifike të varfërisë të përdorur në Kosovë. Përparësia kryesore e qasjes së dytë është se mundëson klasifikimet e mbarëvajtjes duke përdorur distribuimin e konsumit të plotë e jo variablin e pavarur diskrete varfër/jo i varfër të analizës së probitit. Për të dy qasjes modelet vlerësohen ndaras për fushat rurale dhe urbane.

Probabiliteti i të qenit të varfër

Gjatë kontrollimit të variablave tjera, analiza probit tregon se madhësia e ekonomive familjare ka efekt të konsiderueshëm statistikor në zonat urbane, në të cilat ka një trend të kthyeshëm ku gjasat

e të qenit të varfër arrin në 11-12 persona (Tabela A1). Nëse mbahen variablat tjera konstante, gjinia e kryefamiljarit nuk është parashikues i rëndësishëm për përcaktimit nëse ekonomia familjare është e varfër apo jo. Moshja e kryefamiljarit është e ndërlidhur në mënyrë të konsiderueshme me statusin e varfërisë së ekonomisë familjare vetëm në zonat rurale, pas një trendi të kthyesëm që arrin kulmin në moshën 44 vjeçare. Pas kontrollimit të variablave tjera, përbërja e moshës dhe gjinisë së ekonomisë familjare nuk ka marrëdhënie të fuqishme me gjasat e të qenit të varfër në zonat urbane dhe rurale. Në të dy fushat, koeficienti i vetëm i rëndësishëm për ekonominë familjare është se meshkujt nga 17 deri në 64 vjet, përpos që janë të barabartë, ekonominë familjare me më shumë meshkuj në këto mosha kanë më pak gjasa të jenë të varfër.

Arsimimi i anëtarëve të rritur të ekonomive familjare (të definuar këtu si 17 vjet e më shumë) është e ndërlidhur shumë me gjasat e të qenit të varfër si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale në të dy ABEF-të. Siq është pritur koeficientet duhet të bëhen negativ (p.sh. të ndërlidhur me një gjasë më të ulët të të qenit të varfër) duke lëvizur kah nivelet më të larta të arsimimit. Në zonat urbane, koeficienti për arsim fillor të kryer nuk është i rëndësishëm në asnjërën anketë, duke treguar se rritja e proporcionit të të rriturve me arsim të mesëm ose të lartë është i nevojshëm për të zvogëluar gjasat e të qenit të varfër në zonat urbane. Për dallim, në zonat rurale ka përparësi të konsiderueshme për zvogëlimin e varfërisë nga arsimi fillor i kryer edhe pse përparësitë janë më të mëdha për arsimim të mesëm dhe të lartë.

Ekonomitë familjare urbane që parimisht varen nga ndihma sociale dhe pensionet kanë gjasa më të lartë të të qenit të varfër sesa ata që varen nga burimet tjera. Mbështetja në të hyra nga vetëpunësimi dhe paratë e dërguara nga jashtë është e shoqëruar me gjasa më të ulëta të të qenit të varfër në zonat urbane. Në zonat rurale, trendët janë të ngjashme, edhe pse pensionet nuk janë të rëndësishëm statistikiisht. Kur është fjala për aktivitetet kryesore të anëtarëve të rritur të ekonomive familjare, nuk është befasuese që ekonominë familjare me pjesëmarrje më të madhe të anëtarëve të moshës së punës të cilët janë të papunësuar kanë gjasa më të mëdha të të qenit të varfër, edhe pse koeficientet janë të rëndësishëm vetëm në zonat urbane. Ata me proporcion më të lartë të të ardhurave nga punëtorët me pagë kanë gjasa shumë më të vogla të jenë të varfër.

Ka diferenca të dukshme në varfëri përgjatë rajoneve edhe kur kontrollohen variablat tjera. Variablat e fundit në ekuacionet probit janë një set i variablave binare rajonale, që tregojnë dallimet në gjasa të ekonomive familjare në rajonin e dhënë të të qenit të varfër me të njëjtat karakteristika me rajonin e Prishtinës. Për shembull, ekonominë familjare urbane në rajonin e Gjakovës kanë gjasa më mëdha për 25 për qind të jenë të varfër sesa ekonominë familjare të ngjashme në rajonin e Prishtinës, ndërsa ekonominë familjare në rajonin urban të Gjilanit kanë gjasa për 12 për qind të bien në varfëri sesa homologët e tyre urban nga Prishtina. Trendët rajonal janë të rëndësishëm në aspektin statistikor në zonat rurale, duke treguar që ekonominë familjare në të gjitha rajonet, përveç Gjilanit, kanë gjasa më të mëdha të të qenit të varfër sesa ekonominë familjare të ngjashme në rajonin rural të Prishtinës.

Ndërlidhjet e konsumit për ekuivalent të të rriturve

Regresionet e konsumit përdorin të njëjtat variabla shpjeguese si analiza probit, por variabla e varur është logaritmi natyror i konsumit për ekuivalent të rritur. Pra, koeficientet nga regresionet (Tabela A2) mund të interpretohen si ndryshim në përqindje në konsum nga një ndryshim në njësi të një variabile të pavarur duke i mbajtur variablat tjera konstante. Për shkak se variabla e varur është baza e konsumit, interpretimi i shenjave të koeficienteve është e kundërta e analizës probit, ashtu që koeficientet pozitive të jenë të shoqëruara me nivele të larta të mirëqenies e jo me probabilitete të larta të të qenit të varfër.

Pas kontrollimit të variablave tjera, del se mosha dhe gjinia e udhëheqësit të ekonomisë familjare nuk janë parashikues të rëndësishëm të niveleve të mirëqenies. Në regresionin e konsumit as gjinia e kryefamiljarit e as mosha e tij/saj nuk janë lidhje të rëndësishme me konsum në asnjë regresion. Madhësia e ekonomisë familjare është një ndërlidhje (korrelacion) të rëndësishme vetëm në zonat urbane, ku konsumi për të rritur bie (në një shkallë të rënies) me rritjen e madhësisë së

ekonomisë familjare. Efektet e përbërjes së moshës dhe gjinisë së ekonomisë familjare janë më të fuqishme në zonat rurale sesa në ato urbane.

Niveli i arsimimit të anëtarëve të ekonomisë familjare është i ndërlidhur me konsumin edhe pas kontrollimit të faktorëve tjerë. Të gjithë koeficientet e variablave të arsimimit janë të rëndësishëm statistikisht. Ata janë shumë të ngjashëm në aspektin cilësor me ata të analizës probit me madhësinë e koeficienteve në rritje e sipër për nivelet e larta të arsimit dhe me rezultate të fuqishme në zonat rurale për kryerjen e vetëm arsimit fillor.

Ekonomitë familjare që varen parimisht nga ndihma sociale kanë konsum më të ulët në mënyrë të konsiderueshme sesa ekonomitë familjare tjera. Paratë e dërguara nga jashtë janë të shoqëruara fuqimisht me konsum të lartë në zonat e larta, por jo në zonat urbane. Për dallim, varësia në pensione dhe punë me ditë si dhe punësim me pagë janë të ndërlidhura me konsum më të ulët në zonat urbane, por nuk janë të rëndësishme në zonat rurale. Ndërlidhja e pazakonshme negative ndërmjet punësimit me pagë dhe konsumit i treguar në variablat kryesore të të ardhurave të ekonomive familjare kuptohet më së miri në kombinim me koeficientet e rëndësishëm pozitiv për pjesëmarrjen e të rriturve të ekonomisë familjare me punësim me pagë. Siç është përkthyer në seksionin 3.2, shumë ekonomi familjare më të varfra kanë një ose dy anëtarë me punësim me pagë, por kanë edhe disa anëtarë të rritur tjerë të papunë ose kanë punësim me pak të ulët. Kjo është konsistente edhe me koeficientet negative për pjesëmarrjen e të rriturve të moshës së punës të cilët janë të papunë dhe pjesëmarrjes së të rriturve të cilët janë punëtorëve familjar të papaguar.

Rezultatet për variablat rajonale janë shumë të ngjashme me të gjeturat në analizën probit, pasi shumica e rajoneve kanë nivele më të ulëta të konsumit sesa rajoni i Prishtinës, me përjashtimin e vetëm të Gjilanit urban.

4. Konkluzionet

Edhe pse Kosova ka pasur pasoja më të vogla nga kriza ekonomike sesa shumica e vendeve tjera në Evropë, vazhdon të jetë një prej vendeve më të varfra në Evropë. Analizat e ABEF 2009 tregojnë se më shumë se një e treta e popullatës jetojnë nën linjën e varfërisë me 1.55 Euro në ditë për të rritur, dhe 12 për qind nën linjën e varfërisë ekstreme prej 1.02 euro për të rritur në ditë. Edhe pse këto nivele janë më të ulëta sesa ato të raportuara nga ABEF 2005-06 (45.1 dhe 16.7 për qind) nuk është e mundur të bëhen konkluzione të qëndrueshme për trendët e varfërisë për shkak të ndryshimeve në mostrën e ABEF të bëra në vitin 2008. Rritja e BPV-së që nga vitin 2005-06 ka qenë i ngadalshëm por vazhdimisht pozitiv, por është e mundur që së paku disa nga zvogëlimet e dukshme në varfëri të jenë reale dhe të mos jenë vetëm një artefakt për ndryshim në metodën e mostrës, në veçanti nëse indikacioni i ABEF që pabarazia nuk është rritur në mënyrë të konsiderueshme është i saktë. Posa të jetë në dispozicion, korniza e mostrës nga regjistrimi i vitit 2011 do të ndihmojë në ofrimin e një baze të fuqishme për krahasim përgjatë anketave, edhe pse krahasueshmëria e zbatimit të anketës do të kërkohej ende.

ABEF 2009 tregon shkallë të ngjashme të varfërisë në zonat urbane dhe rurale, edhe pse ky përfundim është i ndjeshëm nga zgjedhja e linjës së varfërisë. Varfëria urbane është pak më e lartë se ajo rurale për linjat e varfërisë më të ulëta se 500 euro për të rritur në vit. Për linja më të larta të varfërisë, varfëria rurale është më e madhe me rritjen e dallimit urban-rural gjatë afrimit të linjës së varfërisë prej 750 ose 1000 euro në vit.

Popullata e Kosovës është jashtëzakonisht e re, dhe fëmijët e të rinjtë janë të varfër në mënyrë joproportionale. Në lidhje me këtë, ekonomitë familjare të mëdha (të cilat janë pjesëmarrje të lartë të të rinjve) janë shkallë të larta të varfërisë dhe përbëjnë një pjesë të madhe të popullatës së varfër në Kosovë. Femrat kanë pak më shumë gjasa për të qenë të varfër se meshkujt, edhe pse dallimi

në shkallët e varfërisë tek ekonomitë familjare të udhëhequra nga meshkujt-femrat është më e theksuar.

Arsimimi dhe punësimi janë ngushtë të lidhura me statusin e varfërisë. Arsimimi ka vlerë në vetvete për të përmirësuar mirëqenien por ka edhe vlerë instrumentale për rritjen e mundësive. Ata që kanë të kryer arsimimin e mesëm ose arsimin e lartë kanë shumë më pak gjasa të jenë të varfër sesa ata që kanë kryer vetëm shkollën fillore. Pjesë e shpjegimit për këtë është se ata me arsimim më të larta kanë gjasa më të mëdha të punësimit dhe të marrim të ardhura më të larta nga punësimi i tyre. Megjithatë, edhe tek të papunët, ata me nivele më të larta të arsimimit janë më pak të varfër se mesatarja.

Në tërësi shkalla shumë e lartë e papunësisë në Kosovë është një ndikues tjetër i rëndësishëm në nivelet e larta të varfërisë. Shkallët e varfërisë janë të larta posaçërisht tek të papunët dhe punëtorët me punë ditore. Ekonomitë familjare të mëdha janë shumë të zakonshme në Kosovë. Shpesh këto ekonomi familjare duhet të mbështeten në të ardhurat e vetëm një ose dy anëtarëve të punësuar, dhe të ardhurat e tyre nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar tërë familjen. Duhet rritje më e shpejtë e punësimit jo vetëm për të ndihmuar të rriturit e sotëm, por edhe për të akomoduar popullatën e re që hynë vazhdimisht në tregun e punës dhe do të vazhdojë me këtë trend në shumë vite të ardhshme.

Referencat

- Ravallion, Martin. 1994. *Poverty Comparisons*. Fundamentals of Pure and Applied Economics Volume 56. Chur, Switzerland: Harwood Academic Publishers.
- Ravallion, Martin. 2001. "Growth, inequality, and poverty: Looking beyond averages." *World Development* 29(11): 1803–1815.
- Ravallion, Martin. 2003. "Measuring aggregate welfare in developing countries: How well do national accounts and surveys agree?" *Review of Economics and Statistics* 85(3): 645–652.
- Statistical Office of Kosovo. 2010. Results of the Labour Force Survey 2009. Pristina: Statistical Office of Kosovo.
- UNDP (United Nations Development Programme). 2011. *Kosovo Human Development Report 2010*. Pristina: UNDP.
- World Bank. 2005. Kosovo: Poverty Assessment. Report No. 32378-XK. Washington DC: The World Bank.
- World Bank. 2007a. Kosovo Poverty Assessment. Volume I: Accelerating Inclusive Growth to Reduce Widespread Poverty. Report No. 39737-XK. Washington, DC: The World Bank.
- World Bank. 2007b. Kosovo Poverty Assessment. Volume II: Estimating Trends from Non-comparable Data. Report No. 39737-XK. Washington, DC: The World Bank.
- World Bank. 2010. Kosovo Country Economic Memorandum. Unlocking Growth Potential: Strategies, Policies, Actions. Report No. 53185-XK. Washington, DC: The World Bank.

Anekset

Tabela A1: Probabiliteti i të qenit të varfër, 2009

Variabla e varur: i varfër 0/1	Urbane	Rurale
Madhësia e ekonomisë familjare	0.042* (0.016)	-0.008 (0.014)
Katrori i madhësisë së ekonomisë familjare	-0.002** (0.001)	0.001 (0.001)
Ekonomitë familjare me kryefamiljar femër	0.017 (0.040)	-0.024 (0.054)
Mosha e kryefamiljarit	0.008 (0.006)	0.012*** (0.006)
Katrori i moshës së kryefamiljarit	-0.000 (0.000)	-0.000** (0.000)
<i>Konsumi i ekonomive familjare (relative për pjesëmarrjen e fëmijëve 0-6 vjet)</i>		
Pjesëmarrja e fëmijëve 7 – 16 vjet	0.070 (0.087)	-0.050 (0.122)
Pjesëmarrja e femrave 17 – 64 vjet	-0.122 (0.105)	-0.204 (0.146)
Pjesëmarrja e meshkujve 17 – 64 vjet	-0.255** (0.102)	-0.330** (0.136)
Pjesëmarrja e të moshuarve (65+)	-0.039 (0.140)	-0.286 (0.186)
<i>Arsimimi i anëtarëve të EF (relative për të paarsimuar ose moskryerje të arsimit fillor)</i>		
Pjesëmarrja me fillore të kryer	-0.111 (0.075)	-0.158** (0.062)
Pjesëmarrja me të mesme të kryer	-0.252* (0.076)	-0.192* (0.065)
Pjesëmarrja me arsimim të lartë të kryer	-0.596* (0.102)	-0.352** (0.169)
<i>Burimi kryesor i të ardhurave të EF (Relative për “tjera”)</i>		
Të ardhurat kryesore të EF: Pagat publike	0.147*** (0.083)	-0.013 (0.112)
Të ardhurat kryesore të EF: Pagat private	0.207* (0.078)	0.023 (0.116)
Të ardhurat kryesore të EF: Bujqësia	-0.139 (0.130)	-0.088 (0.101)
Të ardhurat kryesore të EF: Puna me ditë	0.167** (0.081)	0.057 (0.103)
Të ardhurat kryesore të EF: Vetëpunësimi	-0.070 (0.086)	-0.193** (0.095)
Të ardhurat kryesore të EF: Pensionet	0.291* (0.066)	0.097 (0.096)
Të ardhurat kryesore të EF: Paratë e dërguara nga jashtë	-0.075 (0.083)	-0.152*** (0.092)
Të ardhurat kryesore të EF: Ndihma sociale	0.352* (0.057)	0.178*** (0.096)
<i>Aktiviteti kryesor i anëtarëve individual të EF (relative me “tjera”)</i>		
Pjesëmarrja e të punësuarve me pagë	-0.356* (0.123)	-0.356* (0.123)
Pjesëmarrja e të punësuarve familjar të papaguar	0.063 (0.082)	0.013 (0.104)
Pjesëmarrja e të pensionuarve/aftësi të kufizuara	-0.172 (0.105)	-0.142 (0.143)
Pjesëmarrja e të papunëve	0.184** (0.077)	0.121 (0.075)
<i>Rajoni (relative për rajonin e Prishtinës)</i>		
Ferizaji	0.157*	0.348*

Variabla e varur: i varfër 0/1	Urbane	Rurale
	(0.057)	(0.052)
Gjakova	0.250*	0.265*
	(0.041)	(0.054)
Gjilani	-0.119*	0.027
	(0.041)	(0.059)
Mitrovica	0.020	0.150*
	(0.037)	(0.055)
Peja	0.094***	0.229*
	(0.056)	(0.051)
Prizreni	0.052	0.102***
	(0.058)	(0.053)
Numri i vëzhgimeve	1,280	1,102

Shënim: variablat e varura: 1 nëse i varfër, 0 nëse jo i varfër. Koeficientet janë efekte mesatare marginale (efemar). Gabimet standarde, të mbledhura në nivel të PSU, në kllapa

Nivelet e rëndësisë: *** $p < 0.01$, ** $p < 0.05$, * $p < 0.10$

Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në SBF 2009

Tabela A2: Regresionet e konsumit, 2009

Variabla e varur: logu natyror i konsumit ekuivalent për të rritur	Urban	Rural
Madhësia e ekonomisë familjare	-0.104* (0.019)	-0.012 (0.016)
Katrori i madhësisë së ekonomisë familjare	0.005* (0.001)	0.000 (0.001)
Ekonomitë familjare me kryefamiljar femër	-0.073 (0.048)	0.017 (0.064)
Mosha e kryefamiljarit	0.007 (0.006)	-0.005 (0.007)
Katrori i moshës së kryefamiljarit	-0.000 (0.000)	0.000 (0.000)
<i>Konsumi i ekonomive familjare (relative për pjesëmarrjen e fëmijëve 0-6 vjet)</i>		
Pjesëmarrja e fëmijëve 7 – 16 vjet	-0.019 (0.102)	-0.098 (0.123)
Pjesëmarrja e femrave 17 – 64 vjet	0.058 (0.130)	0.174 (0.138)
Pjesëmarrja e meshkujve 17 – 64 vjet	0.049 (0.111)	0.215 (0.131)
Pjesëmarrja e të moshuarve (65+)	-0.109 (0.199)	0.395*** (0.209)
<i>Arsimimi i anëtarëve të EF (relative për të paarsimuar ose moskryerje të arsimit fillor)</i>		
Pjesëmarrja me filllore të kryer	0.083 (0.083)	0.193* (0.072)
Pjesëmarrja me të mesme të kryer	0.426* (0.089)	0.310* (0.083)
Pjesëmarrja me arsimim të lartë të kryer	0.865* (0.107)	0.717* (0.222)
<i>Burimi kryesor i të ardhurave të EF (Relative për “tjera”)</i>		
Të ardhurat kryesore të EF: Pagat publike	-0.314* (0.094)	-0.071 (0.130)
Të ardhurat kryesore të EF: Pagat private	-0.315* (0.089)	-0.096 (0.136)
Të ardhurat kryesore të EF: Bujqësia	0.082 (0.138)	0.091 (0.128)
Të ardhurat kryesore të EF: Puna me ditë	-0.415* (0.103)	-0.077 (0.130)
Të ardhurat kryesore të EF: Vetëpunësimi	-0.043 (0.082)	0.199 (0.133)
Të ardhurat kryesore të EF: Pensionet	-0.521* (0.106)	-0.148 (0.129)
Të ardhurat kryesore të EF: Paratë e dërguara nga jashtë	-0.029 (0.100)	0.280** (0.129)
Të ardhurat kryesore të EF: Ndihma sociale	-0.705* (0.114)	-0.315** (0.129)
<i>Aktiviteti kryesor i anëtarëve individual të EF (relative me “tjera”)</i>		
Pjesëmarrja e të punësuarve me pagë	0.370* (0.095)	0.633* (0.117)
Pjesëmarrja e të punësuarve familjar të papaguar	-0.208** (0.097)	-0.003 (0.120)
Pjesëmarrja e të pensionuarve/aftësi të kufizuara	0.164 (0.122)	0.035 (0.150)
Pjesëmarrja e të papunëve	-0.413* (0.078)	-0.262* (0.078)
<i>Rajoni (relative për rajonin e Prishtinës)</i>		

Variabla e varur: logu natyror i konsumit ekuivalent për të rritur	Urban	Rural
Ferizaji	-0.348* (0.062)	-0.452* (0.061)
Gjakova	-0.423* (0.056)	-0.336* (0.066)
Gjilani	0.011 (0.055)	-0.147** (0.068)
Mitrovica	-0.086 (0.063)	-0.198* (0.066)
Peja	-0.217* (0.057)	-0.359* (0.062)
Prizreni	-0.237* (0.059)	-0.300* (0.056)
Konstant	6.956* (0.246)	6.488* (0.275)
Numri i vëzhgimeve	1,280	1,102
R ²	0.474	0.321

Shënime: Variabla e varur: logu natyror i konsumit ekuivalent për të rritur. Gabimet standarde, të mbledhura në nivel PSU, në kllapa.

Nivelet e rëndësisë: *** p<0.01, ** p<0.05, * p<0.10

Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në SBF 2009



Zyra e Bankës Botërore në Kosovë
Mujo Ulqinaku Nr.3
10000 Prishtina, Kosovë
P: (381-38) 249-459

<http://www.worldbank.org/kosovo/>



Statistical Office of Kosovo
Enti i Statistikës të Kosovës
Zavod za statistiku Kosova

Enti i Statistikës i Kosovës
Rr. Zenel Salihu nr. 4
10000 Prishtina, Kosovë
P: (381-38) 235-111 / 235-474
F: (381-38) 235-033

<http://www.ks-gov.net/ESK>